

VENDIM
Nr.131, datë 19.4.2004

**PËR KOMISIONIN HETIMOR PARLAMENTAR PËR HETIMIN NË KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për hetimin në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH).

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për detyrë hetimin e informacioneve publike dhe të denoncimeve të bëra për problemet dhe detyrat që kryen KESH-i. Në mënyrë të veçantë komisioni hetimor duhet të hetojë rreth informacioneve dhe denoncimeve për menaxhimin e rezervës ujore të sistemit hidroenergjetik, për praktikën e prokurimeve publike, sidomos për shitblerjen e energjisë elektrike nga KESH-i, për praktikën e faturimit të konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët privatë, si dhe për aplikimin e regjimit të kufizimeve të energjisë elektrike.

III. Periudha që do të mbulohet nga hetimi është periudha nga data 1 janar 2002 deri në datën 30 prill 2004, por, nëse del e nevojshme, Komisioni mund të hetojë edhe që nga viti 1994.

IV. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga maxhoranca parlamentare dhe 5 nga opozita, si më poshtë:

- | | |
|-------------------|-------------------|
| 1. Jemin Gjana | - Kryetar |
| 2. Eduard Alushi | - Zëvendëskryetar |
| 3. Dilaver Qesja- | anëtar |
| 4. Edi Paloka | - anëtar |
| 5. Alfred Çako | - anëtar |
| 6. Jak Ndokaj | - anëtar |
| 7. Ejup Tabaku | - anëtar |
| 8. Flamur Hoxha | - anëtar |
| 9. Lekë Çukaj | - anëtar |
| 10. Kristo Goci | - anëtar |
| 11. Ndue Preka | - anëtar |

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej dy muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi